Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr.060/01-20180/2022
Kaçanik, 18.07.2021

# FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VII (Shtatë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës ,në Sallën e Komiteteve të Kuvendit , më datë: 25.07.2022 ( e Hënë ) më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli

Në mbledhjen e VII (Shtatë ) të Rregullt të KPF-s të datës, 25.07.2022, do të shqyrtohet ky:

**REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF -s;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhëm Janar – Qershor 2022;
3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve;
4. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë;
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Raporti i punës së KKSB për gjashtë mujorin e parë 2022;

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**01Nr. 60/01-16843/22**
**Kaçanik, 22.06.2022**

**P R O C E S V E R B A L**

Nga mbledhja e **VI (gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 22 qershor 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.
Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, dhe Ardita Rrahmani. Në mbledhje mungoj me arsye, Rabije Sallahi.
Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive: Dardana Tafili-Dauti –DAP, Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, ndërkaq nga zyrtarët ishin: Gafurr Loku- zyrtar në DSHMS, Rakip Vishi-zyrtar në DUKMM, Arbnora Kuka.-asistene e Kryesuesit të KK.
Mbledhjen e monitoroj Farku Dërmaku- OSBE,
Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, para se me filluar me rendin e punës, shprehi shqetësimet për mospjesëmarrje të anëtarëve të KK në debatet publike të organizuara nga organet e komunës dhe mospjesëmarrje në trajnime të organizuara nga DEMOS. Konstatoj kuorumin, kushte pune për me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të KPF-a për vitin 2022, data, 22 qershor, me këtë:

**REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

2. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

3. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale 01208-2, Mal i klasës 3 në sipërfaqe 504m2 dhe livadh i klasës 3 në sipërfaqe 1722m2 në emër të Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga f. Sllatinë;

4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 000129-8 zona kadastrale Bob, në vendin e quajtur "Oborr", Arë e klasës 6, pronë e Blerim (Ajet) Çaka nga Bobi-Kaçanik;

5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 350m2 në parcelën kadastrale 02302-2 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Shoko bare kalishtë" në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet;

6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 001334-13 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër;

7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 001334-12 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Burim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër;

8. Plani i Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në objektin e administratës komunale të komunës së Kaçanikut;

9. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës për vitin 2023-2025;

10. Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021;

11. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2021;

12. Propozim vendim për transfer dhe rialokim te mjeteve sipas buxhetit 2022.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

**APROVON**

**Rendin e punës në përbërje prej 12 pikëve.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

**1.** Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush ndonjë vërejtje lë të urdhëroj. Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 5 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj Ardita Rrahmani për shkak së nuk ka qenë pjesë e procesit. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**APROVON**

**Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 23.05.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-13311/22.**

**2.** Propozim Vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe në legjislaturën e kaluar ka ekzistuar një komision për zgjedhjen e Këshillave lokale, ai këshill është në fund të mandatit, atëherë duhet bëhen zgjedhje të reja. Besoj se drejtoria bashkë me DBF e kanë paraparë edhe koston buxhetore, sepse kemi pasur telashe me anëtarët e komisionit që nuk u paguan. Një pjesë e komunave janë duke i paguar komisione, me UA është me i paguar deri në 6 takime. Kur të formohen komisionet nga KK është mirë me ia caktuar edhe formën e pagesës. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Me intereson me ditur, a kanë ndonjë afat të përcaktuar kohor ky komision për zgjedhjen e këshillave lokale ?
**Kryesuesi i Kuvendit:** Sigurisht këto komisione janë Ad hoc, komisionet ad hoc i përfundon mandati pasi të përfundojnë aktivitetin për të cilin janë zgjedhur.

**z. Agim Mani:** Komisioni i cili formohet në KK për zgjedhjen e Këshillave të fshatit, mundet me zvarritur procedurën, për këtë arsye po pyes se, a ka ndonjë plan të përcaktuar se deri kur duhet me përfunduar punën e tyre komisioni ?

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Komisioni nuk paguhet, por duhet me u paguar administratorët e fshatrave dhe lagjeve urbane, ata të cilët e kryejnë punën nëpër pika e zona për ku janë zgjedhur. Komisioni kanë me kryer punën e vet në terren, kanë me i zgjedhur administratorët, ndërkaq ata administratorë që zgjedhën, duhet me u paguar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është plani që përcakton çështjen e afatit. Për çështjen e pagesës, është një UA që përcakton edhe shumën e anëtarëve të komisionit që duhet paguhen, në të kundërtën nuk po pranojnë me marrë pjesë në komisione anëtarët, sigurisht se kemi me pasur edhe anëtarë nga jashtë. Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni t'i shkojë KK ky propozim Vendim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Propozim Vendimin për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale. Këtë pikë KPF ia,**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**3.** Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale 01208-2, Mal i klasës 3 në sipërfaqe 504m2 dhe livadh i klasës 3 në sipërfaqe 1722m2 në emër të Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga f. Sllatinë;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Meqë PZHK ka tejkaluar afatin e vet, ndërkaq po përballemi me kërkesa deri me miratimin e PZHK të ri. Është një hendek mes planeve zhvillimore, çështjet shkojnë në shqyrtim të ligjshmërisë, disa po kalojnë disa po kthehen në rishqyrtim. Kërkoj mirëkuptimin e juaj. E hapi diskutimin e kësaj pike:

**znj. Ardita Rrahmani:** Për derisa ekziston kjo zbrazëtirë, a kishim pasur mundësi që paraprakisht lëndët për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore fillimisht të shkojnë në MAPL, pastaj t'i shqyrtojmë ne këtu në bazë të vlerësimit të organit shqyrtues.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk ka mundësi, sepse organi shqyrtues i shqyrton vendimet e jo propozim vendimet. Për ndërrimin e destinimit të klasës nga 1-4 merr vendim ministria, atë të klasës 5 dhe 6 KK, ndërkaq 7-8 drejtoria.
**z. Agim Mani:** Të çështja e ndërrimeve të destinimit të tokave bujqësore, është mirë që paraprakisht komuna – DUKMM me shkuar me marrë një Pëlqim në MBPZHR, pastaj në bazë të atij pëlqimi me vendosur komuna. Kërkesën që e bënë pala, me qenë e kompletuar, me qenë edhe data e kërkesës, se po bien në kundërshtim me shkresat tjera të lëndës. Në asnjë kërkesë nuk figuron data e parashtruesit të kërkesës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është një komision i formuar i cili i trajton kërkesat, pastaj në bazë të tyre i trajtojmë ne këtu. Komuna pas 10 viteve duhet me bërë PZHK të ri. Kërkesat kanë evoluar, çështja se kthehen disa vendime të kësaj natyre nga organi shqyrtues, është së PZHK. PZHK është

në hartim e sipër, por ende nuk është përfunduar. Me PZHK të ri, besoj se kanë me u zvogëluar kërkesat për ndërrim destinimi, sepse një pjesë e tokës bujqësore do të parashihet me PZHK. Për derisa nuk janë të parapara me planin e vjetër, PZHK i ri ende nuk është gati, ne do të procedojmë në këtë formë, ndërsa ana teknike, data etj. është në obligim të drejtorisë me i përmbushur ashtu si është e rregulluar. Po e shoh të kjo lëndë se sipërfaqja është e madhe, ndërkaq duhet me ua sqaruar palëve për taksat që duhet paguar për sipërfaqen e caktuar për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, sepse pala mund të dëmtohet për ndërrimin e destinimit, sepse shuma e pagesës është e madhe.

**z. Agim Mani:** Ku është bazuar komisioni që ka dalë në vendngjarje me ia ndërruar destinimin kësaj prone bujqësore ? Lexoni kërkesën e palës se çka thotë, se nuk është specifikuar në kërkesë sipërfaqja për ndërrimin e destinimit. Komisioni kur të del në vendngjarje, duhet me ditur se për cilën pronë është fjala. Do të ishte më mirë që kërkesa me qenë profesionale, që me ditur se çka po kërkon pala.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pala nuk është profesionale, kështu që kërkesa nuk mund të bëhet profesionale. Pala ka kërkuar me iu ndërruar destinimi pronës së tij, kështu që është e qartë kërkesa. Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

**Aprovoj**

**Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale 01208-2, Mal i klasës 3 në sipërfaqe 504m2 dhe livadh i klasës 3 në sipërfaqe 1722m2 në emër të Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga f. Sllatinë. KPF këtë pikë ia**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**4.** Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 000129-8 zona kadastrale Bob, në vendin e quajtur "Oborr", Arë e klasës 6, pronë e Blerim (Ajet) Çaka nga Bobi-Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe kjo pikë është e natyrës së njëjtë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Edhe të kjo lëndë, kërkesa nuk ka datë kur është adresuar, d.m.th. mungon data e adresimit të kërkesës së palës?

**znj. Ardita Rrahmani:** A ka komuna protokoll, nëse ka, pse nuk figuron protokolli, se kjo është e vetmja dëshmi që tregon se kur është regjistruar lënda. Kishte me qenë praktikë më e mirë që në secilën fletë me pasur protokoll, mos me lënë hapësirë për dyshime. Lë të mbetet si propozim që vula e protokollit me iu vendosur lëndës.

**z. Rakip Vishi:** Lënda ka numër të protokollit, në mbështjellës është shënuar edhe data, ndërkaq në lëndë vetëm numri i protokollit.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Kjo nuk e paska vulën e protokollit, zakonisht të gjitha lëndët e kanë vulën, ku shënohet numri i protokollit dhe data.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

**Aprovoj**

**Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 000129-8 zona kadastrale Bob, në vendin e quajtur "Oborr", Arë e klasës 6, pronë e Blerim (Ajet) Çaka nga Bobi-Kaçanik. KPF këtë pikë ia**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**5.** Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 350m2 në parcelën kadastrale 02302-2 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Shoko bare kalishtë" në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin e kësaj pike:

**z. Agim Mani:** Edhe të kjo lëndë protokollimi është bërë me 17.05.2022, ndërkaq kërkesa me 18.05.2022.

**z. Rakip Vishi:** Sqaroj se për datën e vlerësimit të lëndës nga komisioni vlerësues.

**z. Sabedin Vishi:** Kjo lëndë është e muajit të kaluar, por e njëjta ka ardhur me vonesë, kështu nuk e kemi proceduar në atë mbledhje.

**znj. Ardita Rrahmani:** Në vlerësimin e komisionit thuhet se aprovohet kërkesa e palës e datës 18 maj, ndërkaq në faqen tjetër të njëjtën ditë është formuar komisioni me 18 maj, d.m.th. në të njëjtën ditë është bërë kërkesa dhe është formuar komisioni. Kjo mund të jetë gabim teknik, sepse të njëjtën ditë me u bërë kërkesa dhe komisioni nuk është e mundur.

**z. Ramadush Osmani:** Lëndës i vendoset numri i kërkesës. Nëse është gabuar numri i lëndës, atëherë është diçka tjetër, ndërkaq data ka pasur mundësi me u gabuar.

**znj. Ardita Rrahmani:** Lëndës në secilën fletë i vendoset protokolli, kjo është dëshmi për datën e regjistrimit të lëndës dhe nuk lënë hapësirë për dyshime.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

**Aprovoj**

**Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 350m2 në parcelën kadastrale 02302-2 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Shoko bare kalishtë" në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet. Këtë pikë ia**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**6.** Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 001334-13 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin e kësaj pike: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

**Aprovoj**

**Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 001334-13 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër. Këtë pikë ia**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**7.** Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 001334-12 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Burim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër;

**Kryesuesi i Kuvendit**: E hapi diskutimin e kësaj pike: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

**Aprovoj**

**Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m2 në parcelën kadastrale 001334-12 zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, Arë e klasës 5, në vendin e quajtur "Perovina", në emër të Burim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër; Këtë pikë ia**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**8**. Plani i Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në objektin e administratës komunale të komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit**: Fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani:

**z. Ramadush Osmani:** Pasi e miratuam rregulloren për mbrojtje nga zjarri, tani e kemi hartuar planin. Është ky një plan teknik, ku përcaktohen saktë detyrat e secilit punëtor punonjës dhe struktura organizative në rast të ndonjë fatkeqësie, tërmete, vërshime, kërcënime. Në raste të tilla secili i ka detyrat si me vepruar, se është suksese në raste të tilla nëse arrihet me shpëtuar jetë njerëzish, si rasti konkret që ishte rasti i Restelices. Planit iu ka bashkangjitur skicat, të cilat do t'i vendosim në secilin kat për udhëzimet të nevojshme sesi duhet vepruar në raste të tilla. Plani është hartuar nga grupi punues i shtabit të emergjencave.

**Kryesuesi i Kuvendit**: E hapi diskutimin e kësaj pike:

**z. Agim Mani:** A është menduar ndarje e buxhetit për realizimin e këtij plani ?

**z. Ramadush Osmani:** Aspektet buxhetore janë të ndërlidhura me secilën drejtori nëse mendohet për blerjen e pajisjeve kundër zjarrit, ndërlidhen me DAP, nëse mendohet ndërtimi i shkallëve emergjente, ndërlidhet me buxhetet që janë në kuadër të KAB, e kështu me radhë.

**znj. Kadrije Lika- Troni:** Edhe rregullorja kur është miratuar, patëm diskutuar për çështjen e shkallëve emergjente. Unë nuk mundem me imagjinuar realizimin e këtij plani pa pasur shkallë emergjente. Shkallët emergjente janë prioritet që duhet me ndarë buxhet për to. Unë e jap si propozim që me realizuar vendosjen e shkallëve emergjente, e mos me pasur këtë problem, sepse sa do që mbahen trajnime , sado që bëhen investime, nuk mundet me u bërë asgjë nëse nuk janë në funksion shkallet emergjente

**z. Ramadush Osmani:** Plani për një reagim emergjent, fatkeqësia nuk dihet se ku mund të ndodhë, shkallet emergjente nuk janë ndonjë faktor që munden me na shpëtuar nëse ndodhë eksplodimi të shkallet emergjente dhe mbyllen shkallet, ndërkaq nga struktura ne e dimë se kemi një dalje veriore e një dalje jugore e personit që e organizon shkallet e jashtme në ndërtim nuk llogariten se sulmet e jashtme vijnë nga thyerjet. Ky është plan i përgjithshëm emergjent, në rast termet, vërshimi, zjarrvënëse, kështu që mënyra e evakuimit dhe shpëtimit dallon varësisht nga natyra e aksidentit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t' shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

**Aprovoj**

**Planin e Reagimit Emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në objektin e administratës komunale të komunës së Kaçanikut. Këtë plan KPF ia,**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

9. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës për vitin 2023-2025;

**Kryesuesi i Kuvendit**: E hapi diskutimin e kësaj pike:

**znj. Ardita Rrahmani:** Fatkeqësisht nuk kam pasur mundësi me marrë pjesë në debate publike të organizuara për KBA. Kam një pyetje dhe kërkesë, këtu mundemi me paraqitur kërkesa për miratim deri në fund të shtatorit kur miratohet buxheti. Rruga "Idriz Seferi" a është paraparë diçka me kornizë, duke marrë parasysh së ministria nuk po e përfundon këtë projekt, e di që është në fazën finale, por për një shumë 200.000€ ka ngelë pa përfunduar ky projekt, ndërkaq është rruga e parë në qytet afër komunës.

**z. Bahri Selimi:** Është shqetësim me vend, kryetari ka qenë në ministri, sivjet është e parapamë kjo rrugë, sqarime të hollësishme të jep kryetari.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**: Është shqetësim me vend, se ke qenë pjesë kur është nisur ajo rrugë, nuk po dua me akuzuar askënd, ministria e ka marrë obligim dhe i ka paraparë 176.000 € në vitin e kaluar. I kam pasur 2 takime me zëvendësministrin, një memorandum me ministrin Abrashi e ka shkëputur ministria, ata me kanë thënë se janë futur projekte që nuk kanë mbulesë, dhe nuk mundemi me realizuar sivjet. Projekti është i vitit 2016, në vitin e ardhshëm me kanë thënë sivjet ky projekt realizohet. Tani e kanë zvogëluar buxhetin për këtë projekt, në 50.000 €, nuk i di arsyet, kam pyetur më kanë thënë së është vendimi i yni. Ata me kanë thënë se gjatë muajit prill kemi me iu ftuar për me nënshkruar memorandum të bashkëpunimit, unë nuk iu tregova se kam ndarë mjete për këtë projekt, procedurat me thanë se keni me i udhëhequr ju. Unë kërkova me i udhëhequr ministria procedurat, për shkak të paragjykimeve, por nuk pranuan, erdhi qershori dhe nuk kemi përgjigje edhe pse kam kërkuar në vazhdimësi me u takuar se paku me na thënë udhëzime rreth këtij projekti, se janë 2 kode për këtë projekt, njëri nga ministria e tjetri nga komuna, përgjigje nuk kemi marrë, ndërkaq adresa e qytetarëve është komuna. Kam dërguar email zyrtar, por nuk kam përgjigje.

**znj. Ardita Rrahmani:** Faleminderit për përgjigjen kryetar, mos realizimi i këtij projekti është neglizhencë e organeve. A ka mundësi me marrë këtë projekt në realizim vet komuna e më bërë zgjidhje të këtij projekti dhe tjetra, pse komuna mos me marrë tenderin për këtë projekt, që të përfundon ky projekt, se është e turpshme si komunë mos me bërë një presion në nivelin qendror,

se janë qytetarët ata të cilët po i vuajnë pasojat e mos koordinimit të komunës me ministrinë. Qeveritë ndërrohen shpesh, ndërkaq qytetarit nuk i intereson kush është në qeveri, qytetarit i intereson realizimi i projektit. Të mbetet si propozim apo iniciativë nga GP i LDK që me i marrë përsipër për realizimin e këtij projekti, se u përmend se komuna e ka ndarë një shumë buxhetore për realizimin e këtij projekti.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**: Janë 2 kode për këtë projekt, komuna i udhëheq procedurat, por pa e nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me ministrinë, nuk mundet me filluar procedurat. Është për keqardhje, se nuk mundemi me kontaktuar me qeverinë, që kjo nuk ka ndodhur me qeveritë tjera, këtu u bënë 16 muaj e nuk kam mundur me u takuar, nuk i di arsyet. Kërkoj edhe nga asamblistët që janë këtu, jam në gjendje me shkuar me ta kurdo që me thërrasin, vetëm e vetëm të realizohet projekti, arsyet nuk i di. Përpara i kemi pasur derën qelë të secili ministër. Kjo nuk po vlen të ne për momentin, edhe kur po kërkoj, nuk me japin një përgjigje, a me filluar me procedurat apo jo, me na dhënë një rrugëzgjidhje. Jam në pozitë të pa-lakmueshme, jam 2 asamblistë këtu, kurdo jam në gjendje me shkuar në ministri, po pres edhe nja 10 ditë mos po reflektojnë, unë jam në gjendje në çdo kohë me shkuar për këtë projekt për hir të qytetarëve.

**znj. Ardita Rrahmani:** Tani është bërë problem me u takuar edhe me zëvendësministra. Unë në emër të GP të LDK i bashkëngjitëm kërkesës, ku do të marrim pjesë edhe ne në takimin që do të caktojnë. Jam me i dhënë fund realizimit të këtij projekti, janë 2 asamblistë të LVV këtu nëse mund t'i bashkëngjitën kërkesës tonë.

**z. Agim Mani**: Është keq nëse kjo rrugë është neglizhuar nga niveli qendror, mirëpo është keq që kjo rrugë është neglizhuar që 20 vjet qeverisje të PDK në Kaçanik. Që 20 vjet qeverisin LDK e PDK në pushtetin qendror dhe është neglizhuar kjo rrugë, ndërkaq akuzohet qeverisja e LVV për 1 vit pushtet, kjo nuk është ferr, se kjo rrugë është dashur të jenë moti me prioritet, se është rrugë shumë afër qytetit.
**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**: Që 20 vjet është punuar, ky projekt ka qenë me prioritet në vitin 2015, por për shkak të shkëputjes së kontratës së një kompanie të papërgjegjshme, ka ngecë, pastaj janë çështja e ankesave se kompania ka të drejtën e ankesës. Unë po e akuzojnë çështjen e mos komunikimit, nuk po i lë fajtor për rrugën, por tani nuk po akuzoj për projekte që 15 vjet, se para 15 vjetëve nuk ka pasur rrugë as në Stagovë, Unë nuk po e akuzoj ministrinë për shkëputje kontratës, por çështja është mos komunikimi.

**z. Agim Mani**: Komunikimi i mirë që po thonë kryetar që keni pasur me qeveritë tjera, nuk ka sjellë rezultat.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**: Komunikimi me ish ministrat as me ministrin Lutfi Zharku nuk kanë munguar, ata nuk kanë mundur me ndërhyrë në procedura gjyqësore, por komunikimi nuk ka munguar. Unë kam pasur kontakte me ministrin e kulturës, por me ministrin e infrastrukturës jo, nuk i di arsyet, zëvendësministrit i kam dërguar email zyrtar, nuk me është përgjigjur.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Kur ka qenë kërkesa e fundit që iu keni adresuar zëvendësministrit, në mënyrë që t'i dimë do rrethana.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**: Takimi i fundit ka qenë në mars, me ka thënë se do t'i ftoj kryetarët e komunave në javën e parë të muajit prill për nënshkrim të marrëveshjes së memorandumit. Procedurat ka thënë udhëhiqni ju, se ne kemi shumë punë. Kur kërkova takimin e

dytë, nuk kam më përgjigje, iu kam shkruar disa herë. Po pres me më thirrur me bërë një rrugëzgjidhje.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Sigurisht edhe ata të nivelit qendror i kanë agjendat e veta. Kryetar, nëse është nevoja duhet me shkuar direkt atje. A keni marrë pjesë në një takim që iu ka ftuar kryeministri se kishe pasur mundësi aty për aty dhe me diskutuar për këtë problem që e keni.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**: Unë kam qenë me termin të zëvendësministrit vitin e kaluar, ndërkaq kam pritur gati gjysmë ore.

**z. Agim Mani**: Është shumë keq me dëgjuar sidomos prej kryetarit të komunës

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**: Nuk desha me hyrë në këtë temë, por çështje është me gjetur një zgjidhje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A bënë të rregullojmë këtë çështje, se a është mirë apo a është keq, është në ndërgjegjen a atij që t 'pret e jo atij që vjen me u takuar. Të kryetari i komunës cilido që vjen me u takuar nga anëtarët e KK, pavarësisht subjekteve politike, nuk ka kurrfarë problemi. Ministri është për krejt popullin e jo për subjektin politik, ne po e shohim si po qeverisin, por çështja është se pasojat i vuajnë të gjithë qytetarët. Çështja sa i ka kushtuar komuna rëndësi kësaj rruge, po shihet se është në procedurë nga viti 2016. Neglizhencat kanë ndodhur në krejt qeveritë, por tani, komuna ka paraparë edhe mjete të veta nëse nuk realizohet nga qeveria. Qeveria nuk duhet me bërë klasifikime komunale, duhet me qenë njëjtë për të gjithë. Në të gjitha takimet kërkoj me ma dhënë mundësia për takime, mos me pasur decentralizim të buxhetit, të ndahen mjetet prioritetet i caktojmë vet, e jo me u caktuar prioritetet sipas ministrave që janë në qeveri, se kjo nuk është në rregull

**z. Agim Mani:** Kjo vlen edhe për nivelin lokal, e jo prioritete të caktohen nëpër kafe.

**z. Bahri Selimi:** Janë organizuar dëgjimet publike për buxhetin, por nuk keni ardhur, as shefja e jonë e GP nuk ka ardhur.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**: A me tregon Agim cila rrugë në Stagovë është anashkalua.

**z. Agim Mani:** Rruga të unë, faza e parë është bërë në vitin 2018, ndërkaq faza e dytë nuk është kryer kurrë. A e keni marrë ju një vendim nga këshilli i f. Stagovë se cilat rrugë i ka vendosur me prioritet? Këshilli i fshatit ka vendosur për disa rrugë dhe ju ia keni kthyer, unë kam qenë në atë këshill. Kemi marrë vendim për rrugën "Ekrem Gudaqi" ju e keni hequr nga prioritetet.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi;** Vendimin e kam marrë nga Administratori i fshatit, jo nga këshilli, investimet janë bërë në fshatin e juaj në prioritete me 90%. Ju mundeni me thirrur Naimin dhe Kemalin, në mbledhje të KK dhe nëse unë ia kam refuzuar kërkesat e administratorëve për projekte, po dal sot publikisht e po jap dorëheqje, se nuk jeni duke thënë të vërtetën, unë nuk e Kam ndryshuar por a ka ndryshuar administratori. Ju keni pasur mundësi me i bërë 20 kërkesa, por administratori i juaj i ka përcaktuar se cilat janë më prioritete, unë pa lejen e administratorit nuk hequr asnjë projekt.

**znj. Ardita Rrahmani:** Devijoj debati, a kishim pasur mundësi me dërguar në mbledhje të KK një kërkesë me të gjithë anëtarët e KK për një takim të kryetarit të komunës me ministrin për një arsye. Ne jemi të zgjedhurit e popullit, ndërkaq ministrat janë të emëruar politik, pasisë që jemi të

zgjedhurit e popullit, e kemi prioritet një takim me ta, ku i paraqesim kërkesat tona, me i bërë kërkesat e administratorëve, besoj se edhe anëtarët e KK nga LVV munden me na ndihmuar në këtë drejtim, lë të mbetet si propozim, ndërkaq sa realizohet nuk e di.

**z. Agim Mani:** Unë me kujtohet një rast kur kam pasur një takim me drejtorin për çështjen e rrugës së Stagovës. Para 2 viteve drejtori me ka thënë se në këtë vit është në plan ajo rrugë, por rruga nuk është kryer.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi;** Nëse të ju kam diskriminuar juve, atëherë e kam diskriminuar edhe vetën time, se i kam nja 84m2 rrugë pa shtruar fare midis f. Kaçanik i Vjetër. Të ministri Arditë kam qenë, me ka pritur shumë mirë vitin e kaluar, por me tha se do kompetenca ia kam kaluar zëvendësministrit, Me pat premtuar me ardhur në vizitë në Sharr me pa se qysh janë dëmtuar pyjet. E kam thirrur edhe deputetin e komunës tonë, ia kam dhënë të gjitha projektet, d.m.th. e kam shfrytëzuar autoritetin tim si kryetar i komunës. Për komunën tonë nuk kanë futur projekte të reja, por kanë hequr, të Hani i Elezit kanë futur edhe projekte të reja, me vjen mirë për këtë. Projektet krejt i kanë atje, është viti i katërt se nuk po e akuzoj vetëm qeverinë aktuale, që nuk kemi asnjë projekt të ri, janë projektet e vjetra që kanë vazhduar., por ndonjë projekt të ri nuk kemi., nja 26 kërkesa për projekte i kemi në sirtarët e tyre. Këto janë mundësitë e mia që i kam shfrytëzuar si kryetar i komunës për prioritete në ministrinë e infrastrukturës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që KBAK të shkoj në procedurë të KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës për vitin 2023-2025. Ky dokument i,**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**10.** Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin e kësaj pike: Për diskutim nuk u paraqit kush, a jeni që ky raport t'i shkoj KK në formë informate? Të gjithë u pajtuan. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e pati në shqyrtim Raportin e Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021. Në saje të kësaj del konstatimi se, **Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021, i kalon Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.**

**11.**Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që ky plan t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KP, **Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2021, ia procedon Kuvendit të Komunës për shqyrtim.**

**12.** Propozim vendim për transfer dhe rialokim te mjeteve sipas buxhetit 2022:

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

**z. Bahri Selimi:** Janë do donacione për bujqësi, është kushti që ne të kontribuojmë nën 49% të projektit. Shoqata i ka ndarë 80.000€, ne jemi duke menduar me i ndarë 60.000€, është një shumë që shkojnë për sera, mbi 200 sera kanë me u shpërndarë. Pjesa e parë është shuma 80.000 € që kanë me u ndarë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Propozim vendimin për transfer dhe rialokim te mjeteve sipas buxhetit 2022. Këtë pikë KPF ia**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**z. Agim Mani:** Ishte i interesuar të di për pikët 13 dhe 14 që janë në KK, a kanë me u anuluar apo si do të veprohet me ato dy pikë?

**znj. Ardita Rrahmani:** Kemi biseduar me herët se ka me u formuar Grupi joformal të grave. Nëse formohet ky grup, kërkoj të formohet para pushimeve verore.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pikat 13 dhe 14 trajtohen vetëm në KK e jo edhe në KPF. Sa i përket grupit të grave, pas mbledhjes së KK ndalemi e debatojmë këtë çështje.
Për fund, ua kujtoj edhe njëherë, një trajnim të organizuar nga DEMOS me datën 23 dhe 24 qershor, me anëtarët e KPF dhe zyrtarë tjerë.
Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:13. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF sa ishin edhe në fillim. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 27 Qershor 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
**Komuna e Kaçanikut**
Opština Kačanik/Municipality of Kaçanik
**Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

KAÇANIKU

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| Data 19.07.2022 | Vendi KAÇANIK | |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01- | 104/02-20245 | /22 |

Data: 18.07.2022

Në mbështetje të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6, pika b dhe h, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës nëpermjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtjes së Mjedisit:

**Propozon**

Në mbështetje të nenit 5, dhe 6 pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 4 të Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Vendimit 01Nr. 104/02-38073/21 të datës 29.12.2021 nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut dhe Statutit të Komunës së Kaçanikut neni 6 shkronja h), që në mbledhjen e datës ______________ të merr këtë:

# VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
*NË SHFRYTËZIM AFATGJATË*

1.Me këtë Vendim fillon procedura nga komisioni vlersues për Dhënien në Shfrytëzim AFATGJATË, për pronat e paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, personave fizik dhe juridik.

2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim të cekura si në pikën 1. të këtij Vendimi, për dhënie në shfrytëzim në periudhë afatgjatë kohore janë:

**2.1** .Njësia Kadastrale me nr.00293-0, me kulturë kullosë e klasës 3, me sipërfaqe prej 03.49.00 ha, zona kadastrale Duraj.

**2.2.**Njësia Kadastrale me nr.01866-0, me kulturë livadh i klasës 5, me sipërfaqe prej 00.68.68 ha, zona kadastrale Kaçanik.

**2.3.**Njësia Kadastrale me nr.00232-0, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 02.01.36 ha, zona kadastrale Kotlinë.

**2.4.**Njësia Kadastrale me nr.00156-2, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 01.49.74 ha, zona kadastrale Koxhaj.

**3.**Pronat e përcaktuara në njësitë kadastrale të pikave; 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij Vendimi, janë prona të Komunës së Kaçanikut.

**4.**Procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe me Rregullores (QRK) –


Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, 71000 Kaçanik; Tel. 038 200-46400; e-mail: zekir.selimi@rks-gov.net

Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës do t'i zhvilloi, Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës, i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës.

5. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës

6. Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga MPL.

Kryetari i Komunës
z.Besim Ilazi

## Arsyetim

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është; krijimi i kushteve për zhvillim të bizneseve, krijimi i mundësisë për investime nga investitorë vendor dhe të huaj, me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës.Gjithashtu njësitë kadastrale të lartëcekura janë pjesë e listës së veçantë të pronave komunale me Vendimit 01Nr. 104/02-38073/21 të datës 29.12.2021 nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2022.

Drejtori
Qamil Stagova


Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, 71000 Kaçanik; Tel. 038 200-46400; e-mail: zekir.selimi@rks-gov.net

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917035-00293-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | Certificate draft |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 18.07.2022 - 14:42 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | KAÇANIK / KAĆANIK / KAÇANIK |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Duraj / Dura / Duraj-Gabrricë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | KAÇANIK / KAĆANIK / KAÇANIK |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70917035-00293-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 34900 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| LJOSKAVAC PRONI | | | | |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 34900 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Kaçanikut** | 600246913 | / / / |  | QAMIL ILAZI | 1/1 |  |  |

DRAFT

Z-K- OURAJ - PARC NR. 293-0



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917048-01866-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | Certificate draft |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 18.07.2022 - 14:23 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | KAÇANIK / KAĆANIK / KAÇANIK |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Kaçanik / Kacanik / Kaçanik |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | KAÇANIK / KAĆANIK / KAÇANIK |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70917048-01866-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 6868 | 56-2009; 1-2019 | | 31.01.2019 |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| DUSHKAJA | | | | 31.01.2019 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Livadhet/Livade/meadow | Livadh I Klasës 5/Livada 5 Klase/5th Class Meadow | 6868 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **P.SH. BVI-E BANIMIT;RREGULL.DHE SHFRYTËZIMIT TË TOKËS NDËRTIMORE** | KCID0904223 | KAÇANIK / KAČANIK / KAÇANIK / | | | **1/1** | 56-2009 | |

DRAFT

Z.K. KAÇANIK – PARC. NR. 1866-0



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917052-00232-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | Certificate draft |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 18.07.2022 - 14:33 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | KAÇANIK / KAĆANIK / KAÇANIK |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Kotlinë / Kotlina / Lumbardhi |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | KAÇANIK / KAĆANIK / KAÇANIK |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70917052-00232-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 20136 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| DROSHAC | | | | |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri Broj Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use | Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class | Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture | 20136 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

